



Prishtinë: 30.09.2011

Kodi i ZRRE-së: V_376_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_619_06_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_619_06_11**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 18.07.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Hamdi Haradinaj nga Kastrioti (shifra e konsumatorit DPR – 2005341), si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 23.10.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 12.10.2009 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 22.12.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për kontroll kanë hasur në kyçe ilegale në rrjetin elektrik nga konsumatori Hamdi Haradinaj dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 208506 i datës 22.12.2008
- Me datë 18.02.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR09HP07331 në vlerë prej 2,371.83 €.
Provë: Fatura DPR09HP07331të e datës 18.02.2009
- Me datë 24.02.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 12.10.2009 Departamenti për Konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalet e kontrollës.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 12.10.2009
- Me datë 23.10.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 06.07.2011, DMK ka lëshuar një vendim duke refuzuar pjesërisht ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:
 1. Shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR09HP07331 të datës 18.02.2009 në vlerë 2,371.83 €.



2. Rikalkulojë faturën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike për periudhën gjashtë mujore.

- Me datë 18.07.2011 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_619_06_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: **ZRRE/DMK_V_619_06_11** të mbetet në fuqi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar